



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 95-të të mbajtur më 15.11.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-2298/1 nga 12.04.2023, me pretendimet për fitim të paligjshëm të pronës nga persona fizikë, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse denoncimi nuk përmban pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e detyrave të pushteteve publike dhe detyrave zyrtare.

Lënda me numër 12-2298/1 nga 12.04.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 12.04.2023, një parashtrues i panjohur ka bërë denoncim me pretendimet për fitim të paligjshëm të pronës nga persona fizik dhe është konstatuar lënda me numër 12-2298/1 e datës 12.04.2023.

Në denoncim, parashtruesi, pa iu referuar veprimeve korruptive, vë në dukje një person fizik nga /// për të cilin ka pretendime për fitim të paligjshëm të pronës nëpërmjet personave juridikë në pronësi private - /// dhe ///, të cilët kryejnë veprimtari të lidhura me eksproporimin e xehes nga miniera ///. Në të njëjtën kohë, parashtruesi në denoncim, pa iu referuar veprimeve korruptive, paraqet pretendime të përgjithshme për rritje jo proporcionale të pasurisë së një personi tjetër fizik, nëpërmjet shitjes së një ndërmarrje publike të privatizuar - /// nga ///.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se personat e denoncuar në këtë rast nuk janë zyrtarë në kuptim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe se pretendimet e raportuara nuk janë korrupsion sipas përkufizimit të përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: A.R.M.
Miratoi: B.I

**KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

